



Pranuar / Dorezuar Pimljen / Predato Received / Delivery	09 - 12 - 2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHKA	3048/2020		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.328/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër protokolli 2282/2020 të datës 27.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë rruga "Ferat Zeka" p.n, fshati Negoc Glllogovc kundër organit të punësimit - Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.328/2020 e datës 27.10.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

II.DETYROHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të ndërmarr veprimet e duhura procedurale-administrative të përcaktuara me legjislacionin në fuqi që rregullon çështjen që është objekt i kësaj ankese, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

IV. Vendimi hy në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

A r s y e t i m

■■■■■-Inspektor i tregut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, më datë 27.10.2020 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për shkak të kushteve specifike të punës, dhe punës jashtë orarit. Ankesa e ankuesit është pranuar më datë 27.10.2020 dhe është protokolluar me numër 2282/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.11.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Kjo e fundit më datë 10.11.2020 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë faqe 1/28.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.10.2020 me numër protokoll 2282, parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 27.11.2007, Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 25.11.2009; Akt emërimi i datës 30.01.2012, Përshkrimi i detyrave të punës i datës 31.01.2012, Ndryshimi dhe Plotësimi i aktit të emërimit i datës 10.02.2015, Kërkesë e datës 03.09.2020, Kërkesë e datës 04.09.2020, E-mail i datës 03.06.2020, e-mail i datës 03.09.2020, e-mail i datës 14.05.2020, e-mail i datës 27.10.2020, e-mail i datës 06.05.202, Kërkesë e datës 05.05.2020, Inspektoratet në Kosovë organizimi dhe funksionimi-gap mars 2014, Ligji Nr.04/L-186 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoriatin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, Ankesa e parashtruar me datën 07.05.2015 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 28.05.2015 me numër protokoll 903, Kërkesa sipas Qarkores Buxhetore 2021/02 e datës 25.09.2020, Qarkorja Buxhetore 2021/02 kërkesat shtesë dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 10.11.2020 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/28.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është *pjesërisht e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 10.02.2015, ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës Inspektor i Mbikëqyrjes të Konsumit të përgjithshëm të tregut në inspektoriatin e tregut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ankuesi më datë 03.09.2020 ka parashtruar kërkesë me numër protokoll 5265 në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për njohjen e të drejtës për pagesën e shtesës mbi pagën bazë për kushte specifike në punë, ndërsa në mungesë të përgjigjes nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ankuesi më datë 27.10.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se i takon e drejta në realizimin e shtesës në pagë për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e

Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, i publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për njohjen e të drejtës për realizimin e shtesës në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analizuar legjislacionin në fuqi, ka konstatuar së dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, përkatësisht neni 10.A paragrafi 1 përcakton së: *“Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit të punës”*, andaj, si rrjedhojë e kësaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se ankuesit, respektivisht Inspektorëve të Tregut, sipas dispozitave të ligjit të veçantë, iu njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë mirëpo duke u bazuar në paragrafin 2 të këtij neni ku përcaktohet së: *Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhet konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil, Kolegji vlerëson se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për ankuesin mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse respektivisht Ministria përgjegjëse për administratë publike, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 16 paragrafi 1, ku përcaktohet se: ... institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se ... për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës. si dhe nenit 10.2 të kësaj rregullore ku përcaktohet se: çdo shtese dhe kompensim nuk mund të realizohet, nëse nuk është planifikuar në buxhetin vjetor të institucionit përkatës.*

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit se me dispozitat e ligjit të veçantë ankuesit i është njohur e drejta në shtesë për kushte specifike në punë, vlerëson se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të ndërmarr veprimet e duhura procedurale-administrative për trajtimin e çështjes që është objekt i kësaj ankese, siç parashihet me dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe dispozitat e nenit 7 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, në këtë kuptim Kolegji ka vendosur për aprovim të pjesërishëm të ankesës dhe detyrimin e organit punëdhënës si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data kur ligji ka hy në fuqi, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar së Ligji Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, është




publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 27.10.2020, andaj vlerëson se pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar për faktin se ankesa është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1, i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ".

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.328/2020, datë 09/12/2020

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit 
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së

